

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE
– SHKUP

ALBANISCHES INSTITUT - ST. GALLEN

Alessandro Barnabò

*SULLE MISSIONI DELL'ALBANIA,
SERVIA E MACEDONIA*

Ed: Albert Ramaj & Skender Asani



albanisches
Institut

Shkup - St. Gallen, 2023

Botues:

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve–Shkup
Albanisches Institut - St. Gallen

Alessandro Barnabò

Sulle missioni dell' Albania Servia e Macedonia, sulle provvidenze da prendersi a vantaggio delle medesime missioni, e sull'Ospizio da fondarsi in Scutari per i Religiosi Francescani.

Ed: Albert Ramaj & Skender Asani

Për botuesin:

Prof. dr. Skender Asani

Bashkëpunorë të këtij botimi:

Mikel Pllumaj

Kastriot Marku

Zef Noka

Jozef Zamputti

Sevdail Demiri

Yll Prebibaj

ISBN: 978-608-4897-72-9

www.itsh.edu.mk

www.albanisches-institut.ch

Të drejtat autoriale janë të rezervuara për autorët dhe botuesit

Copyright©ITSHKSH, 2023

Alessandro Barnabò

SULLE MISSIONI DELL'ALBANIA, SERVIA E MACEDONIA
Sulle missioni dell'Albania Servia e Macedonia, sulle provvidenze da prendersi a vantaggio delle medesime missioni, e sull'Ospizio da fondarsi in Scutari per i Religiosi Francescani.

Mbi misionet e Shqipërisë edhe të Serbisë e të Maqedonisë, në lidhje me provvidencat që duhet të ndërmerren në favor të të njëjtave misione, ose në lidhje me hospicin (strehën) që duhet të themelohet në Shkodër për klerin Françeskan

* * *

Ed: Albert Ramaj & Skender Asani

PËRMBAJTJA - INDICE

FJALA E BOTUESVE.....	7
Mikel PLLUMAJ: NJË PËRSHKRIM I SHKURTËN I KONGREGATËS SË PROPAGANDËS SË FESE	9
Kontributi i Kongregatës për Shqipninë	11
Kontributi i radhës	12
Arsyeja e kësi lloj përmbledhjesh dokumentare	14
Përmbledhja i kushtohet misionit katolik në Shqipni, Serbi e Maqedoni	15
Rendi i dokumenteve	17
Mbyllja	18
SAGRA CONGREGAZIONE DI PROPAGANDA FIDE	19
Emi e Rmi Signori	20
NOTA D'ARCHIVIO	44
ARTICOLO I. Cagioni che han dato luogo ai dissidii tra Vescovi e missionarii e mezzi proposti per rimediarvi.	172
ARTICOLO II. Della esibizione delle patenti e delle facoltà ai Vescovi.	175
ARTICOLO III. Del consenso de' Vescovi per l'uso delle facoltà de' missionarii.....	176
ARTICOLO IV. Delle limitazioni apposte ad alcune facoltà.	182
ARTICOLO V. Della dipendenza delle facoltà de' Missionarii dai Vescovi lungo il tempo del loro esercizio.....	185
ARTICOLO VI. Della dipendenza totale de' missionarii dai Vescovi richiesta ora da Monsig. Dodmasei.....	191
ARTICOLO VII. Esame istituito dalla S. Congregazione sul rendere dipendenti dai Vescovi i missionarii oltre ciò cheesigono i decreti riferiti.	194
Allegato Lett. A. Istruzione del S. Offizio mandata all'Arcivescovo di Antivari per provvedere alla osservanza delle Feste.....	197
Allegato Lett. B. Istruzione mandata nel1761. dalla S. Congregazione al Vescovo di Pulati sulla riserva de' casi.....	199
Allegato Lett. C. Istruzione del 1759. pelVicario Patriarcale di Constantinopoli che per ordine della Congregazione generale degli 11. Maggio 1778. fu mandata all' Arcivescovo di Antivari.....	202
FACULTATES CONCESSE A SS. D. N. D.	207
DISA PJESE NGA MANUSKRIFTI I LIBRIT ORIGINAL	403

FJALA E BOTUESVE

Që në fillim duhet thënë se parathënien e këtij botimi duhej ta shkruane Peter Bartl, të cilin që më parë e kishim informuar për botimin e këtij dorëshkrimi. Për fat të keq, Bartl vdiq më 29 mars 2022 dhe kështu u pamëndësua për të pasur peshën e fjalës së tij në këtë botim.

Bartl ishte një ndër historianët më të mirë të historiografisë shqiptare dhe njohës shumë i mirë i dokumenteve të arkivit të Vatikanit «Propaganda Fide», nga i cili ka publikuar në pesë vëllime «Albania Sacra», dokumentet e dioqezave të Shqipërisë: 1. Ipushkvia e Lezhës (2007), 2. Ipushkvia e Durrësit (2011), 3. Ipushkvia e Sapës (2014), 4. Ipushkvia e Pultit (2017), dhe 5. Ipushkvia e Shkodrës (2021). Këto vepra janë me rëndësi të jashtëzakonshme për të kaluarën tonë. Në të vërtetë, në këto vepra e hasim disa herë emrin e kardinalit Alessandro Barnabò, i cili përmendet edhe në letrat e tij drejtuar ndonjë prelati në trojet shqiptare, apo edhe letrat që i drejtoheshin atij. Barnabò ishte edhe prefekt i Kongregatës “Propaganda Fide”.

Vepra që kemi në dorë, ruhet si manuscript (dorëshkrim) në Bibliotekën e Françeskanëve “Antonianum” në Romë, dhe është e shënuar si “Miss. Franc. D`Albania”, kurse titulli i tij i plotë është: “*Sulle missioni dell’Albania Servia e Macedonia, sulle provvidenze da prendersi a vantaggio delle medesime missioni, e sull’Ospizio da fondarsi in Scutari per i Religiosi Francescani*”, shkruar në gjuhën italiane disa herë. Siç duket, ky manuscript është përgatitur për botim apo ishte në përgatitje e sipër e që duhej të botohej si libër, për çka në fund është shënuar edhe koha e “botimit” - korrik 1865. Arsyeet e mosbotimit të këtij libri në atë vit duhet kërkuar nëpërmjet hulumtimeve tjera plorësuese. Por, 157 vitë më vonë, ne po e botojmë këtë vepër interesante për historinë shqiptare dhe më gjërë, sidomos historinë e françeskanëve në trojet shqiptare.

Kardinali Alessandro Barnabò ka lindur më 2 mars 1802 në Folino të provincës Pergugia të Italisë dhe ka vdekur më 24 shkurt 1874 në Romë. Ai ishte kardinal dhe sekretar i kongregatës «Propaganda Fide». Propaganda Fide kishte shumë të bëjë më trojet shqiptare, kështu që Barnabò e njihnte shumë mirë gjendjen e atëhershme në këto troje. Siç e cekëm edhe më parë, në disa letra të botuara nga Bartl “Albania Sacra” hasim këte emër, jo

vetëm të cekur, por edhe letra që u shkruante ipeshkvinjve, meshhtarëve nga dioqezat shqiptare, apo e kundërta.

Këtë dorëshkrim e ka zbuluar Mikel Pllumaj më 6 dhjetor 2016 në Bibliotekën Françesane “Antoninum” në Romë, katalogizimi “B. Maior 07416”. Libri si i tillë kishte 426 faqe në formatin që ruhet në bibliotekën e lartpërmendur. Atë ditë Mikel Pllumaj e kishte njoftuar Kastriot Markun, i cili e kishte sugjeruar që të botohet, pasi që nuk është i njohur për publikun e gjerë. Të nesërmen, Kastriot Marku kishte njoftuar Albert Ramaj për këtë gjetje. Albert Ramaj e kishte sugjeruar atë që dorëshkrimi sa më parë të dixhitalizohet, gjë që Pllumaj e bëri. Andaj, pasi e pamë këtë material, vendosëm që ta botojmë. Njëherë ishte idea që të botojmë si botim anastatik, apo vetëm ta përkthejmë në gjuhën shqipe. Pas një pune të palodhshme nga Jozef Zamputti, Yll Prebaj e Anilda Mulgeci, ata e përgatitën në word gjithë këtë manuscript dhe vendosëm ta botojmë ashtu siç ishte manuscripti, duke ruajtur origjinalin e tij, pa ndonjë ndërhyrje.

Mbi rëndësinë e librit nuk do të flasim këtu, por të themi vetëm një, se ka shumë gjëra të reja për historinë shqiptare, sidomos për veprimtarinë françeskane në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, por për këto të jep vlerësimin lexuesi. Në fillim të këtij libri, kemi edhe parathënien e Mikel Pllumaj (shkruar në dialektin gegë), e që shpjegon disa gjëra të rëndësishme për këtë vepër.

Albert Ramaj & Skender Asani

Mikel PLLUMAJ

NJË PËRSHKRIM I SHKURTËN I KONGREGATËS SË PROPAGANDËS SË FESË

Kongregata e Shejtë e Propagandës së Fesë (Sacra Congregazione de Propaganda Fide), sot është e njohur si *Kongregata për Ungjillëzimin e Popujve*, (Congregazione per l'Evangelizzazione dei Popoli). Ky është një institucion papnor i themeluar me 6 janar të vitit 1622, prej vetë Papa Gregori XV (Alessandro Ludovisi, 1554-1623), me 22 qershor 1622, përmes bulës papnore "Të panjohurat e provanisë hyjnore" (Inscrutabili divinae providentia). Ideja fillestare në fakt pat kenë ajo e Ministrit Gjeneral të Jezuitëve Francesco Borgia (1510-1572). Ai i pat propozue Papës Piu V (1566-1572) me krijue një grup Kardinalësh qi të merreshin në mënyrë të posaçme me përkujdesjen shpirtnore të misionarëve. Kjo ide pat mbet pezull, sepse Mbreti i Spanjës Filipi II (1527-1598), nuk dëshironte që Kardinalët të përziheshin me punët e misionarëve në Perandorinë e tij. Po të njajtin fat patën edhe iniciativat për këtë ide, që u mor edhe prej Papëve Gregori XIII (1572-1585) e Klementi VIII (1592-1605).

Papa Gregori XV, jo vetëm që e themeloi këtë dikaster, por edhe i dha një organizim të mbrenshëm solid, me baza materiale të nevojshme, e mbi të gjitha sepse në krye të Kongregatës vendosi njerëz fort të zotë, siç ia vlen të përmendim figurën e të parit Sekretar të Përgjithshëm, Mons. Francesco Ingoli (1578-1649).¹ Papa e themeloi këtë institucion në shërbim të veprës së misioneve katolike, për shpalljen e "lajmit të mirë" në Botë. Këtij institucio-

¹ Josef Metzler, *Orientation, programme et premières décisions (1622-1649)*, in «Memoria Rerum», vol. 1/1, Roma 1976, f. 146-196.

² Kujtojmë këtu dy evenimente me randësi të veçantë që në fillimet e para të aktiviteteve të "Kongregatës": e para, kje ajo e vjetit 1627, kur pasardhësi i Papa Gregorit XV, Papa Urbani VIII, (Matteo Barberini, 1623-1644), themeloi Kolegjin Urbanian të "Kongregatës" për formimin e Klerit dioçezan që ishte i destinuem për misionë në vende të ndryshme të botës, "Missio ad gentes"; dhe e dyta, po prej të njajtit Papë u themeluar Tipografia "Poliglotta", për shtypjen e teksteve në gjuhën e popujve për ungjillëzimin e tyre, (Papa Shën Piu X (Giuseppe Sarto 1835-1914) e bashkoi me tipografinë e Vatikanit në vjetin 1902).

ni iu caktuen edhe fushat e veprimit, në të njëjtën bulë Papnore "*Inscrutabili divinae providentia*": shpallja e fesë në mbarë botën, koordinimi dhe drejtimi i misioneve, formimi i klerit dhe riorganizimi i hierarkive vendore, themelimi i instituteve të reja, e në fund mbështetja financiare për mbarvajtjen e misioneve.

Ndër përgjegjësitë më të mdhaja që iu besuen këtij institucioni, kjenë shpallja dhe rrejia e fesë në mbarë botën, veçanërisht për ato vende ku katolikët gjindeshin, të sunduem prej sundimtarëve që nuk i përkitnin besimit katolik, si dhe një kujdes për ato vende ku zhvilloheshin ndasi të ndryshme fetare, apo herezi. Konkretisht nëpërmjet këtij institucioni synohej një ripërtimje e besimit katolik nëpërmjet misionarëve që formoheshin prej kësaj Kongregate.³ Qysh prej Fillimit të saj, Kongregata tregoi një kujdes të veçantë edhe për Shqipërinë që ishte nën pushtimin e osmanëve.

Në këtë mënyrë Selia e Shejtë nëpërmjet këtij institucion⁴, ushtronte juridiksionin dhe përkujdesej për besimtarët katolikë, anëkënd botës. Që në momentet e para, misionarë të ndryshëm filluen të informojnë mbi gjendjen reale të besimtarëve nëpër vende të ndryshme. Në këtë mënyrë shumë shpejt u mblodh një sasi e madhe informacionesh rreth, besimtarëve, misioneve, vendeve e kulturave të ndryshme. Kështu u sigurua një njohje më e saktë për gjendjen fetare e social-kulturore të shumë kombeve. Falë kësaj veprimtarie u depozitue një sasi e madhe dokumentesh, (relacione dhe letra), që vinin prej misioneve të ndryshme anëkënd botës. Kjo mori dokumentesh sistemohej prej arkivistëve të propagandës dhe me kalimin e kohës u shndërruen në një arkiv të pazavendësushëm për kah vlera historike për shumë kombe. Në këtë aspekt nuk bën përjashtim as populli shqiptar, i cili që në hapat e parë të këtij institucioni, tue kenë pjesë e veprimtarisë misionare, mbërrijti me krijue "fondin" e vet dokumentar në të cilin shkonin informacione që përshkruenin gjënë e gjatë realitetin e besimtarëve të misioneve që ndodheshin në krahinat kishtarë të Shqipërisë.

³ Umberto Bertini, *S.C. Di Propaganda Fide*. - I. Storia, in «Enciclopedia Cattolica» Vol. IV, Firenze, 1950, coll. 328-330.

⁴ Nji profil historik më të zgjeruem për "Kongregatën e Shejtë dhe Misionarët" e gjejmë te studiuesi i mirfillitë për këtë institucion aq të randëshëm të Selisë së Shejtë, Joseph Metzler. (Josef Metzler, *Atti del Congresso Internazionale Scientifico di Missiologia. Roma 5-12 Ottobre 1975*, Roma 1976, vol. II, f. 374-400). Ndërsa në gjuhën shqipe është bërë një përmbledhje historike edhe nga Kastriot Marku. *Kongregata e Shenjtë e Propagandës Fide dhe Shqipëria*, që përgatiti Lazer Stani në librin: «*Vatikani dhe shqiptarët*», Lezhë 2014. f. 86-128.

Kontributi i Kongregatës për Shqipërinë

Lehtësisht mundena me shpreh se Arkiva e Kongregatës së Shejtë të Propagandës së Fesë, njihet prej studiuesve si një ndër burimet më të rëndësishme dokumentare për të dhënat fetare e civile të popullsisë shqiptare që prej vjetit 1610 e deri në vjetin 1912. Kujtojmë se realisht një pjesë e rëndësishme e dokumenteve për Shqipërinë janë të publikueme nëpër vepra të ndryshme, siç ia vlen të përmënim veprën e At Fulvio Cordignano-s (*Gjeografia kishtarë e Shqipërisë prej dekadave të fundit të shekullit të XVI deri në gjysmën e shekullit të XVII*)⁵; Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*⁶; At Luigi Marlekaj (*Pjetër Bogdani e Shqipëria e kohës së tij*)⁷; Odette Marquet (*Pjetër Bogdani, letra dhe dokumente*)⁸; Peter Bartl (*Shqipëria e Shenjtë. Relacione të vizitave baritore nga Shqipëria. 1. Ipushkvoinë e Lezhës. 2. Ipushkvoinë e Durrësit. 3. Ipushkvoinë e Sapës*)⁹; Bardhyl

⁵ Fulvio, Cordignano, *Geografia ecclesiastica dell' Albania dagli ultimi decenni del secolo XVI alla metà del secolo XVII*, (*Gjeografia kishtarë e Shqipërisë prej dekadave të fundit të shekullit të XVI deri në gjysmën e shekullit të XVII*), Roma. 1934.

⁶ Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, për vitet e para të Kongregatës që prej 1610 e deri në vjetin 1634, Vëllimi i I, kje botue në Tiranë 1963; po ashtu edhe një vëllim i II, për vjetët 1634 e deri në vjetin 1650, i botuem në Tiranë 1965; e në fund kujtojmë edhe një përmbledhje të tretë të këtij autori të quejtun "*Dokumente për historinë e Shqipërisë*" për vitet 1623-1653 e të botuem në St. Gallen-Prishtinë 2015, dhe Relacione e dokumente për historinë e Shqipërisë (1610-1650) - Relacioni e dokumenti per la storia dell'Albania (1610-1650), St. Gallen-Prishtinë 2018, Studime albanologjike (1941-2013) & Il Settecento Veneziano e l'Albania Turca, St. Gallen-Prishtinë 2020.

⁷ Luigi, Marlekaj, *Pietro Bogdano e l'Albania del suo tempo*, Bari, 1989. E cila është përkthye e botue edhe në shqip, (Jlak, Marlekaj, *Pjetër Bogdani e Shqipëria e kohës së tij*. Shkodër 2008. Kjo vepër kje përkthye prej Willy Kamsit, e po prej të njajtit, u pajis edhe me tregues emnash e shënime të tjera të veçanta.

⁸ Odette, Marquet, *Pjetër Bogdani, letra dhe dokumente*, Shkodër, 1997.

⁹ Peter, Bartl, *Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien, 1. Diözese Alessio. (Shqipëria e Shenjtë. Relacione të vizitave baritore nga Shqipëria. 1. Ipushkvoinë e Lezhës.) Wiesbaden 2007. I njafti autor në vjetën 2007 ka përgatit e botue relacione për Arqipeshkvinë e Durrësit: *Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien 2. Erzdiözese Durazzo. (Shqipëria e Shenjtë. Relacione të vizitave baritore nga Shqipëria. 2. Ipushkvoinë e Durrësit)*, Wiesbaden 2011. Gjithashtu katër vite më vonë ka publikue edhe vëllimin e tretë për Ipushkvinë e Sapës: *Albania Sacra Geistliche Visitationsberichte aus Albanien. 3. Diözese Sappa. (Shqipëria e Shenjtë. Relacione të vizitave baritore nga Shqipëria. 3. Ipushkvoinë e Sapës)*, Wiesbaden, 2014 dhe *Albania Sacra Geistliche Visitationsberichte aus Albanien. 4. Diözese Pulati, Wiesbaden 2017 (Shqipëria e Shenjtë. Relacione të vizitave baritore nga Shqipëria. 4. Ipushkvoinë e Pulatit) dhe Albania Sacra Geistliche Visi-**

Demiraj (*Jeta dhe trashëgimia e Gjon P. Nikollë Kazazit*)¹⁰. Por duhet shtue se një pjesë e madhe e dokumenteve që ndodhen në arkiva nuk janë të shqyrtuem ende. Prandej një shqyrtim më i thellë, i këtyne arkivave ásht më se i domosdoshëm për historinë e kishës në Shqipëri, sepse në këto arkiva ndodhet një sasi e konsiderueshme relacionesh që përshkruajnë një ndër përiudhat më të vështira të popullit shqiptar, sikurse vlen të përmenden përiudhat e kohëve të fundit nga studiuesi Italo Sarro,¹¹ apo kuvendi i mbajtur në tetor të vitit 2015.¹² Dihet se veprimtaria e këtij institucioni pati një rol të pazavendësueshem për katolicizmin shqiptar, por edhe për rrejtin e identitetit kombëtar gjatë periudhës otomane. Në të vërtetë, që prej fillimit të këtij institucioni gjejmë figura të ndrituna të klerit vendas, dhe misionarë që përgatiten prej këtij institucioni për të përtrí misionet katolike në Shqipëri. Po ashtu, kujtojmë se prej shtypshkronës së Propagandës "*Polyglota*", gjatë shekujve u publikuen vepra të ndryshme me karakter gjuhësor dhe fetar, si fjalori i Frang Bardhit "*Dictionarium latino-epiroticum*", 1635¹³; "*Dottrina Cristiana*", 1636¹⁴ e Pjetër Budit; "*Concilium Albanum*", 1706¹⁵; dhe "*Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*", 1716,¹⁶ të Francesco Maria Da Lecce etj.

Kontributi i radhës

Arsyeja që më shtyni me përshkrue në këto pak rreshta këtë institucion fort të randësishëm të kishës katolike, ásht fakti se: me datën 6 dhjetuer të vjetit 2016, ndërsa po mblidhja material për tezën e licencës me temë:

tationsberichte aus Albanien. 5: Diözese Skutari, Wiesbaden 2021 (Shqipëria e Shenjtë. Relazione të vizitave baritore nga Shqipëria. 4. Ipeshkvënë e Shkodrës).

¹⁰ Bardhyl Demiraj, *Jeta dhe trashëgimia e Gjon P. Nikollë Kazazit*, Shkodër 2013.

¹¹ Sarro, Italo, *Kontribut për historinë kishtare të Shqipërisë së Epërme, shek. XVII-XIX*. (Përktheu nga italishtja Arben Ndreca), Shkodër, 2015.

¹² Me rastin e përgatitjeve për 400-vjetorin e themelimit të Kongregatës së Shenjtë të Propagandës së Fesë, pranë Universitetit Papnor Urbanian në Romë për dy ditë me radhë në datat 26 dhe 27 tetor 2015, u mbajt Kuvendi albanologjik me temë: "L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide" - "Shqipëria në Arkivin e Propaganda Fide-s".

¹³ *Dictionarium latino-epiroticum una cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis*, Romae, 1635.

¹⁴ *Dottrina Christiana*, Roma, 1636.

¹⁵ *Concilium Provinciale sive Nationale Albanum Habitum. Clemente XI. Pont. Max. Albano, Romae, Anno 1706*.

¹⁶ *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese. Del P. Francesco Maria Da Lecce. Min. Oss. Rif. Esprefetto Apostolico delle Missioni di Macedonia, Roma, 1716*.

“*Historiografia e Kishës në Shqipni*”, në katalogun digjital të bibliotekës antoniane në Romë, më ra në sy një titull i veçantë: “*Sagra Congregazione della Propaganda Fide - Ponente - Ristretto con Sommario Nota d’archivio e voto. Sulle missioni dell’Albania, Serbia e Macedonia, sulle provvidenze da prendersi a vantaggio delle medesime missioni, e sull’Ospizio da fondarsi in Scutari per i Religiosi Francescani*”. Luglio, 1865¹⁷; që në shqip do ishte: *Kongregata e shejt e fesë - relazione - Përmbledhje e kufizuese me shënime arkivoore dhe votim. Për misionet në Shqipni, Serbi, e Maqedoni, mbi vendimet që duhen të merren për mbështetjen e misioneve, dhe ndërtimin e bujtinës në Shkodër për rregulltarët Françeskanë. Me autor Alessandro Barnabò (1801-1874)*,¹⁸ Kardinal e njikohësisht Prefekt i Kongregatës së Propagandës së Fesë, që shërbeu në atë detyrë prej 19 qershorit të vjetit 1856 e deri me 24 shkurt të vjetit 1874.¹⁹ Libri në fjalë është i një randësie të veçantë si për kah temat që trajton, dhe po aq i veçantë për for-mën që mbart. Temat e trajtueme janë të lidhuna ngushtë me jetën e kishës gjatë shekujve XVII-XIX, në të cilat kuptojmë fort mirë edhe situatën e mjeshërueshme në të cilën gjindej asokohe populli shqiptar. I veçantë për kah

¹⁷ Vendndhja këtij volumi në depozitën e bibliotekës u gjet me numër katalogimi: “B. Maior 07416”, me sa duket i panjohftun prej studiuesave. Libri ka 426 faqe e ku duket kjahtë se janë fashikuj të ndryshëm të mbledhun e të lidhun bashkë.

¹⁸ Kje shugurue meshtar në mars të vjetit 1833. Qysh herët filloi me mbulue detyra me rëndsi; si fillim kje ndihmës kanonik në Bazilikën e Vatikanit, mandej e gjejmë ndihmëskë-shilltar pranë Kardinalit Paolo Polidori (1778-1847). Ndërsa me 6 janar 1836 emërohet kanonik i Bazilikës së Vatikanit, e dy vjet më vonë, në vjetën 1838, Papa Gregori XVI (1831-1846), e emëroi Konsultor i Kongregatës së Propagandës së Fesë. Barnabò njëjhej fort mirë për zellin e tij pastoral, (që e shtynte me qëndrue me orë të zgjatuna në rrëfyestore), njëjhej për inteligjencën e spikatun dhe aftësi të rralla pune. Në detyrën e Prefektit të Propagandës së Fesë në ato vite ishte Prelati Giacomo Filippo Fransoni (1775-1856), qysh prej vjetit 1834 e deri në vjetin 1856, kur edhe vdiq. Mbas Vdekjes së Fransoni-t, Papa Piu i IX, pa asnji hezitim e emëroi Kardinal dhe i besoi detyrën e Prefektit të Propagandës së Fesë. Me 19 qershor të vjetit 1856, u publikue edhe lajmi i emrimit të dyfishitë Kardinal dhe Prefekt i Propagandës. Qysh prej momenteve të para, përshtypjet kjenë pozitive, sa prej pjesës më të madhe u konsiderue njeriu më i pershtatshëm për atë detyrë. Barnabò shërbeu, (deri ditën që u largue prej kësaj jete), si Prefekt i Propagandës së Fesë prej 19 qershorit të vjetit 1856 e deri me 24 shkurt të vjeti 1874. (G. Martina. *Pio IX: 1851-1866, Miscelanea Historiae Pontificiae edita a Facultate Historiae Ecclesiasticae in Pontificia Universitate Gregoriana*, Roma, 1986, Vol. 51, f. 357-359.)

¹⁹ Ndër profilet më të mira historike për Alessandro Barnabò-n e gjejmë te studiuesi Joseph Metzler (J. Metzler, *Präfekten und sekretäre der Kongregation im Zeitalter der neueren Missionsära*, (1818-1918), in «Sacrae Congregationis de Propaganda Fide», Memoria rerum. Rom-Freiburg-Wien 1975, f. 40-48).

forma, mendojmë se âsht për faktin sepse na vjen në formën e "Ponencave" (përmbledhje relacionesh të përzgjedhuna e të përgatituna prej "*Ponentave*" = Relatorë), nëpërmjet të cilave Kongregata shprehte, udhëzimet e veta për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, të misioneve e të besimtarëve. Që të kuptojmë më mirë formën e këtyne lloj dokumentesh duhet me pasë parasysh disa ingranazhe të funksionimit të vetë Kongregatës.

Arsyeja e kësaj lloj përmbledhjesh dokumentare

Duket se qysh prej fillimit, Kongregata, sipas aktit themelues të bulës papnore "*Inscrutabili divinae providentia*", përbahej prej 13 Kardinalëve. Njani prej të 13-ve kryente detyrën e Prefektit, mandej vinin dy Nënprefekta dhe Sekretari i Përgjithshëm. Nji herë në muaj mblihdeshin për "*Aseblenë e përgjithshme*" për me diskutue punët e rëndësishme. Për çdo asamble kishte nji punë paraprake që bëhej nga relatorët përkatës, ose siç thirreshin "*ponentët*" që përgatitnin "*ponencat*"²⁰ (përmbledhje ralicionesh në formë fashikujsh mbi të cilët diskutoheshin tema të ndryshme). Këta fashikuj së bashku me procesverbalet (me diskutimet që bëheshin ose me vendimet që merreshin për ato çashtje që diskutoheshin), ruheshin në *Aktet e Kongregatës së Propagandës*.

Në këto Akte, janë të pasqyrueme aktivitetet dhe vendimet kryesore të Kongregatës në përmbushjen e detyrave dhe të kompetencave të saj që ajo ushtronte ndaj problemeve të ndryshme kishtare. Duhet theksue se çdo fashikull që përgatitej, ishte vetëm për përdorim të mbrendshëm të Kongregatës. Pra relacione të tilla përgatiteshin në nji numër të caktuem kopjesh, vetëm për aq sa ishin pjestarët e asamblesë. Në Arkivën e Kongregatës gjinden nji numër i madh veprash të tilla të përgatituna për shumë vende ndryshme të botës, të rrujtuna së bashku me dosjet përkatëse të procesverbaeve. Siç dihet, vendimi që mori Papa Shën Gjon Pali II, (Karol Józef Wojtyła 1920-2005), për Arkivat e Selisë së Shejtë, në letrën Apostolike "*La cura*

²⁰ Ponente, = relator; riferues. Ka të bëjnë më fashikujt që përgatiteshin prej relatorëve përkatës, dhe ruheshin integralisht në: "*Acta Sacrae Congregationis de Propaganda Fide*" (Aktet e Kongregatës së Shejtë të Fesë). Aktet janë procesverbalet e diskutimeve dhe të vendimeve që merreshin ose për ato çështje që diskutoheshin në "Asambletë e Përgjithshme ose Plenare". Përdorëshin edhe terma të tjerë si raporte, ristretti, të Kardinalëve, e të sekretarëve që ishin pjesëmarrës në takime. (J. Metzler, *Inventario dell'Archivio della Sacra Congregazione per l'evangelizzazione dei popoli*, «de Propaganda Fide», Roma 1988, f. 136.

vigilantissima" (Përkujdesje vigjilente), e vendosi në dispozicion të studiuesve,²¹ atë pasunë të rrallë e fort të çmueshme, të rrejtun gjatë shekujve në vende e forma të ndryshme. Kështu që jo vetëm Arkivi i kësaj Kongregate për të cilën po flasim, po edhe shumë arkiva të tjerë, munden sot, (falë atij vendimi të marrun prej Papës Shën Gjon Pali II), me u vizitue prej studiuesve, e në mënyrë të veçantë prej historianëve si të historisë kishtare po ashtu edhe asaj civile të kombit tonë. Pohojmë me siguri se kjo "ponencë" nuk është e vetmja që flet për Shqipninë. Sikurse kjo përmbledhje dokumentesh, duhet të jenë edhe shumë dokumente të tjerë, që nëse gjinden do t'i pasuronin me informacione të rralla periudhat e ndryshme të historisë së Shqipnisë. Po ashtu edhe në rastin konkret të kësaj përmbledhje dokumentare që po flasim, do t'ishte fort e rëndësishme me marrë në konsideratë *Aktet e Kongregatës së kësaj "ponence"*, që sigurisht do të jenë në një dosje të veçantë me më shumë material, me të cilin ajo u përgatit për me dalë sikurse e kemi tash në dorë, në variantin e shtypun. Pra e kuptojmë prej vetë titullit të kësaj "Ponence" se kemi t'bajmë vetëm me një, *Përmbledhje të kufizuarve me shënime arkivore dhe votim*. Kështu që, me siguri në dosjen përkatëse, kjo "ponencë", duhet të ketë edhe shumë më shumë faqe që i përkasin kësaj ponence, ngaqë vetë titulli specifikon se në këtë "ponencë" gjendet një "përmbledhje e kufizuarve arkivore me shënime e arkivës dhe mendimin e konsultorit të të Kongregatës", që ishte Ministri Gjeneral i Fretënve Kapuçinë At Salvator D'Ozieri (1853-1859). Tue kenë se botimi ka një rëndësi të veçantë për historinë e kishës dhe të vendit tonë për periudhën kohore të shekullit XVII-XIX, po i bëmë një përshkrim të shkurtër.

Përmbledhja i kushtohet misionit katolik në Shqipni, Serbi e Maqedoni

S'parit duhet theksue se kjo "ponencë" që Kongregata e shejtë e fesë ia kushton "Misionit Katolik në Shqipni, Serbi, e Maqedoni", është një përmbledhje relacionesh që ka kaluar nëpër "Asamblenë e Përgjithshme ose Asamblenë

²¹ Papa Giovanni Paolo II, në Letrën Apostolike "La cura vigilantissima" të datës 21 mars të vjetit 2005, shpalli ligjet mbi arkivat e Selisë së Shejtë. Me këtë ligj stabilizohen parimet themelore për organizimin, administrimin, rrejftjen dhe shfrytëzimin e Arkivave të Selisë së Shejtë si dhe të gjitha dikastereve të organizimit të Kuries Romake dhe të gjitha institucioneve që mvaren prej saj. Shiko në: «Acta Apostolicae Sedis,» vol. XCVII, Typis Vaticanis, 2005, f. 353-376

Plenare" (Vjetore). Duhet thënë e "Asamblesë së Përgjithshme ose Plenare", sepse në të vërtetë nuk mund të kuptohet pa një kërkim studimor të posaçëm në "Aktet e Kongregatës së Propagandës", nga e cila prej të dyjave është dhënë kjo "ponencë".

Ndërsa përsa i përket këtyne fashikujve të quejtun "*ponenca*", duhet të kuptojmë se e marrin këtë emërtim prej atyne që i përgatitshin, pra prej "*Ponentiëve*" që përgatinin "*Ponencat*", bazuar në relacionet periodike që dërgoheshin në Kongregatë. Çdo relacion që i dërgohej Kongregatës, përkrahësit situatën fetare e sociale të besimtarëve në Ipeshkvi të ndryshme me tema të veçanta ose të përgjithshme. Relacionet vinin nga Ipeshkvijt, Superiorët e misionarëve, Prefektat si dhe Delegatët Apostolikë që dërgoheshin prej Kongregatës.

Në rastin konkret "*ponentat*" përgatitshin ponencën e radhës mbi relacionet që vinin prej Shqipnisë, Serbisë dhe Maqedonisë, ku edhe gjindeshin Arqipeshkvitë e Tivarit, Durrësit dhe Shkupit si dhe Ipeshkvitë e Lezhës, Pultit, Sapës dhe Shkodrës; këto të fundit sufragane të Arqipeshkvisë së Tivarit. Në këtë "*ponencë*" përfshihen edhe pesë Prefekturat Apostolike, Kastrati, (në Ipeshkvinë e Shkodrës), ajo e Pultit, e Serbisë, e Maqedonisë si dhe ajo e Epirit.

Për krejt këto krahu kishtare, (me sa shihet në tetë pikat e rreshtueme në dy faqet e para të kësaj "*ponence*"), vehen në dukje vështirësi të ndryshme. Ndër këto vështirësi, gjejmë më shumë të theksueme çastjen e mosrespektimit të udhëzimeve të dhanuna prej Konçilit të Arbnit (1703), të cilat konsiderohen si fort të njoftuna në çdo lloj aspekti, por që mjerisht me sa shihet kishin rënë në humnerën e harresës e në shumë Ipeshkvi kishin bërë që të lejoshin shumë abuzime. Prej kësaj çastjeje, vetë Ipeshkvijt tue u gjetë në këtë situatë, i kërkojnë Kongregatës shpeshherë sqarime e ndihmesë për me zgjidhë dyshime të ndryshme në çastjet doktrinale. Tue u gjetë në këto vështirësi, vetë Ipeshkvijt mendojnë me thirrë një "*Sinod Provincial*", në të cilin të mundeshin me i ardhë sa më mirë në ndihmë, kujdesit shpirtnor të besimtarëve. Kjo ide kje paraqitë në "*Asamblenë e përgjithshme*" me 18 Prill të vjetit 1853, në "*Ponencën*" e radhës, ku diskutohej për emnimin e Ipeshkvijve të Tivarit e të Shkodrës. Në këtë mbledhje u dhà pëlqimi që Shqipnia të kishte "*Seminarin Kombtar*" dhe njëkohësisht Ipeshkvijt të mblidheshin sa më shpejt për "*Sinodin Provincial*". Simbas përshkrimeve që bënë Ipeshkvi i Shkodrës Mons. Giovanni Topich o.s.b., (1853-1859), për vështirësi nga më të ndryshmet, Ipeshkvijt nuk u mblodhën për "*Sinodin Provincial*", por ve-

tëm u themelue "Seminari Kombëtar". Po i njëjti prelat njofton "Kongregatën" se me 27 Prill të vjetit 1854, Ipeshkvijt kjenë ftue me i paraqitë me shkrim se cilat prej udhëzimeve të Koncilit të Arbnit respektoheshin e cilat nuk respektoheshin, tue paraqitë edhe arsyet se pse nuk praktikohen; si dhe u kërkohet, të paraqesin me shkrim edhe sugjerime konkrete që duhet të merren përballë nevojave konkrete të besimtarëve në Shqipëri; si dhe të jepshin një mendim mbi "nderimin e duhur ndaj Ipeshkvijve që ndrojnë jetë" si dhe varrimin e mëkatnorëve publikë që lypin falje në herë të dekës.

Nji vjet më vonë (1855), u mblodhën krejt relacionet dhe iu dorzuen Ministrit Gjeneral të fretëve Kapuçinë At Salvator D'Ozieri, (që ishte njëherash edhe konsultor pranë Kongregatës), të jepte mendimin e tij, tue pasë parasysh edhe vendimet e marruna në Konçilin e Arbnit. Ndërsa Konsultori At Salvator D'Ozieri po kryente punën që i ishte besue prej Kongregatës, ia mbrijnë edhe shumë e shumë relacione me çastje të tjera, kjoftë prej Ipeshkvijve, kjoftë prej rregulltarëve, tue kerkue në mënyrë specifike se për të mirën e misioneve të naltpërmenduna duhej vetë Kongregata, (tue pasë parasysh edhe mendimin e shprehun prej Konsultorit të Propagandës At Salvator D'Ozieri), të shprehte gjykimin e vet.

Rendi i dokumenteve

Në fashikullin e parë të kësaj "ponence", gjejmë temat që shtrihen për diskutim, të cilat ndahen në katër pjesë, e ku merren në shqyrtim çastje të ndryshme të jetës së kishës të cilat binin ndesh me udhëzimet e dhanuna prej Koncilit të Arbnit, si dhe tema tjera të ndryshme, të cilat formulohen në formë pyetjesh për diskutim. Numri i pyetjeve që do merreshin në Shqyrtim nga "Kongregata" ishte i përbamë prej 40 sosh, ku mbas shqyrtimit të tyre duhej që vetë institucioni të shprehte mendimin e vet për zgjidhjen e çastjeve që shtroheshin për diskutim. Mbas kësaj vjen fashkulli me titull: "Nota d'Archivio" (pocesverbalet), ku përshkruhet shqyrtimi i mbi 40 pyetjeve për të cilat Kongregatës i kërkohet të shprehte gjykimin e vet. Në fund të këtij fashikulli gjejmë edhe "Facoltates Concessae", ku shprehen opsionet e dhanuna për 27 shqyrtimet e konsiderueme prej Kongregatës. Fillë mbas tyre gjindet edhe fashikulli që përshkruen shqyrtimet e bame prej Konsultorit të Kongregatës At Salvator D'Ozieri. Në fashikullin e fundit të kësaj "Ponence" gjejmë "Sommario", ose nji përmbledhje të kufizueme të relacio-

neve të dërgueme në Kongregatë prej Ipeshkvijve, Ministrave Gjeneralë të Françeskanëve e prej Prefektave të Prefekturave Apostolike.

Mbyllja

Këto pak rreshta që u rreshtuen për këtë përmbledhje dokumentare në fjalë, të quejtun *''Ponente''*, si dhe ato pak të dhana historike që prumë për institucionin e Kongregatës së Shejtë, e që u përshkruen më sipër, nuk janë asgjâ tjetër përveçse një ndihmesë e vogël për ata studiues që do të kenë rasë me e kalue nëpër duer këtë botim, në mënyrë që të mundën me pasë më të kjiartë kontekstin historik të Institucionit të Propagandës së Fesë dhe përmbajtjen e dokumenteve të dala prej tij. Veçanësija e këtyne dokumenteve të panjoftuna deri më tash në historiografinë shqiptare, përbán një shteg intersant për studiuesit e ardhshëm, shteg të cilit shpresoj se nuk do t'i mungojnë ndjekësat në të ardhmen, në mënyrë që të njihen sa më shumë punët e mdhà që ka bà ky institucion për Shqipninë. Mendoj se është shumë e rëndësishme që studiuesat të kenë në dorë burime të kësaj natyre, mirëfilltas arkivore, të cilët për shkak të specifikës së vetë veprës, t'i jepnin publikut të interesuem në një botim anastatik, e mbasi që të jetë marrë në shqyrtim do-sja përkatëse e kësaj *''Ponence''* në arkivat e *''Kongregatës së Shejtë''*, të ribotohet i përkthyer dhe i pajisun me të gjithë elementët e duhun filologjikë që kërkon një botim i karakterit shkencor për një publik më të gjânë.

SAGRA CONGREGAZIONE
DI
PROPAGANDA FIDE

ponente

L'eminentissimo e Reverendissimo Sig. Cardinale

Alessandro Barnabò
Prefetto

RISTRETTO CON SOMMARIO NOTA D'ARCHIVIO E VOTO

**Sulle missioni dell'Albania Servia e Macedonia, sulle
provvidenze da prendersi a vantaggio delle medesime
missioni, e sull'Ospizio da fondarsi in Scutari per i Reli-
giosi Francescani.**

Luglio
1865

Emi e Rmi Signori

1. La missione dell'Albania, Serbia, e Macedonia comprende attualmente tre Arcivescovadi cioè Antivari, Durazzo, e Scopia e quattro vescovadi cioè Alessio, Pulati, Sappa e Scutari, i quali sono suffraganei di Antivari.
2. In essa vi sono cinque Prefetture Apostoliche, cioè quella di Castrati nella Diocesi di Scutari quella di Pulati, quella della Serbia, quella di Macedonia, e quella dell'Epiro, la quale fu stabilita circa il 1832 quando cessò di esistere la Provincia Minoritica Albanese (Somm. pag. 49. c. IV.) Le prime quattro sono affidate ai Minori Riformati, e sono missioni propriamente dette, la quinta ai Minori Osservanti, ed ha cinque ospizii senza cura di anime, due nella Diocesi di Alessio, uno nella Diocesi di Sappa, e due in quella di Durazzo.
3. Al regolare andamento della medesima missione, si volle provvedere nel secolo passato con le prescrizioni del Sinodo Albanese celebrato nel 1703. le quali sono in realtà sapientissime sotto ogni rapporto.
4. Col tempo però molte di esse furono quasi dimenticate, e molti abusi invece si erano introdotti nelle varie diocesi. Quindi i Vescovi spesso ricorrendo alla S. C. per avere la soluzione di dubbj per lo più dottrinali, fecero nascere l'idea di un sinodo provinciale, onde gli stessi Vescovi avessero preso di comune accordo quelle provvidenze, che trovavano salutari a quella cristianità.
5. Questa fu appunto la mente espressa dal Sacro Consesso nella generale adunanza dei 18. Aprile 1853. quando si occupava della Ponenza per la elezione dell'Arcivescovo di Antivari e del Vescovo di Scutari. Vi era in essa il dubbio 2. così enunciato "Se debba prendersi alcun nuovo provvedimento circa il Seminario nazionale Albanese", al quale si rispose "affirmative et ad mentem mens est, che L'Emo Prefetto insinuvi efficacemente ai Vescovi di riunirsi al più presto in sinodo provinciale, dando ai medesimi analoghe istruzioni, perchè possa il medesimo avere vantaggiosi risultati, e fra questi si ponderi se e dove riaprire un Seminario Albanese, affidandone la direzione ad una Congregazione Regolare insegnante".

6. Scrittosi peraltro in proposito a Monsig. Giovanni Topich allora Vescovo di Scutari, si venne a conoscere che per molti e gravi motivi non potevansi i Vescovi riunire; e però non valendosi ritardare più oltre quei provvedimenti salutari, che esigevano le circostanze di quelle diocesi si procurò la istituzione del Seminario, com'è ben noto all' EE. LL. RR., e si diresse una circolare a tutti i Vescovi, con la quale ai 27. Settembre 1854 furono invitati a riferire esattamente ciò, che delle singole prescrizioni del precitato Sinodo Albanese nelle rispettive Diocesi era in osservanza, e tutto ciò che delle medesime era andato in disuso, come pure i motivi, che avevano dato causa alla inosservanza, seguendo nella relazione l'ordine tracciato nell' indice delle materie del sinodo in parola; non che ad aggiungere il progetto di quelle speciali provvidenze, che giudicavano doversi adottare in rispetto ai presenti bisogni dei fedeli dell'Albania, ed il loro parere sopra due quesiti relativi allo spoglio dei Vescovi, ed alla sepoltura dei pubblici peccatori, che si convertono in punto di morte.
7. Nel seguente anno 1855 si ebbero le relazioni dei medesimi Prelati, le quali furono subito stampate, e passate alla chiara memoria di Monsig. Salvatore d'Ozieri allora Ministro Generale dei PP. Cappuccini, e Consultore di questa S. C. con invito di prenderle a disamina, e di emettere su di esse il suo Voto senza perdere di vista il mentovato sinodo, di cui gli fu rimesso un esemplare.
8. Mentre il lodato Consultore stava facendo il commessogli lavoro, nuove istanze, nuovi dubbj, e nuove questioni furono promosse dai Vescovi e dai Religiosi di quelle missioni, le quali attesochè o versano sopra materie già toccate nell'enunciate relazioni, o sono tali, che non possono da quelle distinguersi, se voglia provvedersi efficacemente al buon andamento delle missioni suddette, così ora si assoggettano all'autorevole giudizio dell'EE. LL. unitamente al voto di quel Consultore, ed alla nota di Archivio disposte, per maggior chiarezza, secondo l'ordine del Sinodo Albanese
9. Merita primieramente ogni considerazione la ignoranza dei popoli albanesi nelle cose della religione. Alcuni ignorano anche il simbolo apostolico, e non sanno farsi bene il segno della S. Croce. I Vescovi ripetono questa ignoranza dalla trascuratezza dei genitori nel mandare i loro figli nella chiesa, dalla lontananza, in che sono le ville dalla chiesa parrocchiale, dalla non

PARTE I.

curanza della istruzione religiosa, dal numero troppo ristretto dei Missionari, e finalmente dalla negligenza dei parrochi. Per rimediarvi propongo no due mezzi, cioè costringere con le pene ecclesiastiche a frequentare la chiesa quelli, che ne sono vicini, ed ordinare ai parrochi di visitare le ville lontane istruendo i ragazzi (Somm. pag. 2. 22. 38. 52. 66. c.V. 72. §. 8. 73). Il Consultore aggiunge che nei diversi villaggi si potrebbero incaricare alcune pie Donne della istruzione catechistica dei fanciulli (pag. 9.). Nella Nota d'Archivio pag 1. si riportano le disposizioni prese da questo Sacro Consesso sui tre mezzi proposti per rimediare all'ignoranza dei popoli, e si accenna come il medesimo prescrisse ancora ai parrochi la istruzione catechistica da farsi entro la messa conventuale, la distribuzione degli esemplari delle dottrine compendiose in lingua albanese, e la diligenza di fare apprendere un formolario di preci contenente le cose principali a sapersi.

10. Sulle feste è da notarsi che sebbene nell'Albania siasi introdotto il Calendario Gregoriano, pure in alcune parrocchie delle montagne si celebra la festa del Titolare o Patrono secondo l'antico Calendario (Somm. pag. 2. 22. 39. c. VII.). Tale abuso, dice l'Arcivescovo di Durazzo, deve ascriversi alla caparbietà del popolo ostinato in ciò da tempo immemorabile, affinché, come osserva il Vescovo di Alessio, sia agli amici più facile l'accesso al convento. Però l'Arcivescovo di Antivari afferma non essere a sua notizia che alcuno de'suoi antecessori siasi dato carico di estirpare un siffatto inconveniente; e questa forse è la ragione, per cui si deplora tuttora. Del resto nella Nota d'Archivio pag. 7. si fa osservare che la S. Congregazione avvertendo che ciò si faceva per la soverchia familiarità dei cattolici coi turchi e scismatici, non ha mai lasciato d'insistere presso i Vescovi perché ammonissero i loro sudditi a non coltivarla troppo: e che il Visitatore di Scutari e Pulati nel 1837 assicurava essersi tolto quasi per ogni dove il rimembrato abuso.

11. Le feste non si osservano a dovere; in esse non si ascolta la S. Messa, e si lavora (Somm. pag. 2. c. VII. pag. 22. C. VI; pag. 39. 53. c. VII. 72. §.13.). I Vescovi parlando su questo punto quantunque non omettano di riprovare la negligenza dei loro sudditi, pure non lasciano di scusarli in qualche maniera in vista della lontananza, in cui sono dalla chiesa parrocchiale, della loro povertà, per cui sono costretti frequentare il mercato, che si tiene nella Domenica e di fare altri lavori campestri (Somm. pag. 52. c. VII.). Osservando poi essersi ottenuto dal Governo Turco che il mercato si trasporti nel Mercoldi, e così essersi tolto un grandissimo ostacolo per l'osservanza delle

feste, chiedono la riduzione delle feste medesime (Somm. pag. 39. c. VII. e num. IX. pag. 75.), non che le facoltà di permettere ai loro diocesani di correre al mercato ec. se cada in giorno festivo. Il consultore conviene sulla domandata riduzione delle feste, dissente sulla chiesta dispensa per i giorni di mercato se coincidano con i festivi, e propone anche un mezzo facile per far sentire a tutti la S. Messa in questi giorni di mercato (pag. 5. 35). Nella *ponenza sui varj dubbj proposti dal Vicario Apostolico di Scopia*, di cui si trattò nel generale Consesso dei 20. Luglio 1840. la S. C. prendendo ad esame il dubbio XIV nel quale si domandava come dovesse agirsi nei casi, in cui i cristiani fossero costretti o dal Governo Turco o dai Padroni a lavorare nei giorni festivi ; il XV nel quale si esponeva che i fornari erano obbligati dal Governo a fare il pane nei giorni di festa e però non potevano sentire la messa, come anche i Cristiani servi dei Turchi ; ed il XVI in cui si chiedeva cosa dovesse prescriversi agli agricoltori, che per la lontananza dalla chiesa parrocchiale quasi mai ascoltavano la S. Messa nelle feste, rispose ad XIV *rescribendum indulgenter prout in nola Archioii et in voto Consultoris*, che si allegarono nella indicata *ponenza*; ad XV. *rescribendum acque indulgenter juxta doctrinam notissimam probatorum auctorum, et juxta praxim*; ad XVI. *Indulgenter juxta sententiam probatorum auctorum*. L'indulgenza poi insinuata dal Consultore al dubbio XIV. succitato era questa: *“Si autem Gubernium, aut domini particulares, seu heri Christifideles adigent ad laborandum Dominicis, aliisque festis diebus in contemptum Catholicae Religionis, nullo modo. eis licitum est illis laborare. Si vero hujusmodi contemptus absit, non esse inquietandos miseros illos catholicos, qui coacti ad laborandum, non sine periculo gravis damni possent aut Gubernio, aut Dominis non obtemperare, et ab imperatis operibus abstinere. Hortandos tamen esse ut missae saltem his diebus intersint: quod si omnino non possint, diutius saltem orent, actus virtutum theologialium, et contritionis renovantes, aliasque impositas preces devote recitantes. Quoad demum christianos illos, quorum opera utuntur Turcae in suis templis, vulgo MOSCHEE, aedificandis, detur responsio ...Decembris 1837”*. Nella nota di Archivio pag.8. si riportano i varii temporanei indulti, che in proposito sono stati accordati a quasi tutte le diocesi dell'Albania, e si osserva non esservi attualmente pericolo, che la riduzione delle feste faccia impressione agli Albanesi come nel secolo passato.

12. E anche da notarsi che le giovanette non vanno mai in chiesa a sentire la S. Messa, e la parola di Dio. Per verità le medesime si tennero sempre riguardate nell'Albania per timore che non fossero rapite dai Turchi ed anche

per inveterati pregiudizii del paese. In vista di che nella pochezza *sulla visita diocesana delle chiese di Scutari e Pulati* proposta nella seduta generale dei 13. Marzo 1837. al dubbio VII. “*Se si possa tollerare che le ragazze altesi gl’insuperabili pregiudizii del paese non ascoltino mai in alcuni luoghi la S. Messa, se non le poche volte che si celebra in casa loro, e che non veggano lo sposo, nè si domandi il loro assenso, se non all’ epoca della nuziale benedizione*”. Si rispose “*Det operam Episcopus ut sensim inducatur consuetudo cognoscendi idoneo tempore nupturum puellarum consensus*”, senza che affatto si toccasse la prima parte. Però nella allegata pochezza *sui varj dubbj proposti dal Vicario Apostolico di Scopia*, la quale venne subordinata dalla S. C. il di 20. Luglio 1840, chiestosi in primo luogo “*se dovessero i parenti obbligarsi a mandare le fanciulle alla chiesa, o se no che opera pia ingiungere ad esse invece della S. Messa*”, si rispose “*affirmative ad primam partem, ad secundam provisum in prima, vel certe curet ut puellae, quae minime missae intersunt, domi orationi vacant, et catechismum audiant*”. L’attuale Vescovo di Scutari implora in modo speciale una provvidenza in proposito (Somm. Num. XLI. pag. 160.). Egli fa notare che attualmente non vi è quel timore, il quale una volta poteva consigliare i genitori a tenere riguardate le proprie figliuole, ed osserva che tutte le ragazze di 12. anni si, lasciano vedere nelle case, e per le strade; dopo poi la indicata età quelle delle famiglie benestanti non escono dal recinto delle proprie case, mentre quelle di bassa condizione, e che stanno a servire, vanno per le pubbliche strade, sebbene involte in un lenzuolo, nel fiume a lavare i panni, e nel mercato. È questo un’abuso, che si deplora nelle missioni dell’Albania, malgrado le prudenziali misure prese in varie circostanze dalla Propaganda, come l’ EE. LL. RR si compiaceranno di ponderare nella Nota d’Archivio pag. 17.

13. L’astinenza generalmente si osserva nei giorni prescritti, più però nella qualità che nella quantità dei cibi; poichè la gente è tutta povera, ed occupata nei lavori di campagna, e manca del cibo necessario particolarmente nella stagione di primavera (Somm. pag. 2. 39. 55. c. VIII.). In Antivari vi è qualche inosservanza. In Scopia il digiuno è osservato scrupolosamente (Somm. pag. 66. §§. VII. e VIII.). Domina in qualche luogo il pregiudizio che chi ha fatto sette quaresime consecutive non sia più obbligato a digiunare (Somm. pag. 54. Cap. IX.). I Vescovi di Alessio e di Pulati opinano doversi trasportare al tempo del Sacro Avvento i digiuni, che cadono nella primavera e nell’estate, particolarmente se si accorda la riduzione delle feste (Somm. pag. 39. 53. c. VIII.) eccettuando i quattro tempi, e le vigilie di Pen-